



Pranimi / Dorezuar Punime/Pradato Received/Delivered	21-06	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Append	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTK	3247/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.474/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani –anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.474/2021 të datës 01.06.2021 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokate Teuta Beka Bunjaku me adresë banimi rruga “Gari Baldi”1/2 Prishtinë, kundër organit të punësimit, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.06.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.474/2021 e datës 01.06.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi i datës 28.04.2021 me nr.385/2021 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

### A r s y e t i m

Ankuesja më datë 29.05.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 01.06.2021 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar më Nr. Prot:2765/2021, me pretendimin ankimor, kundër Vendimit të datës 28.04.2021 me nr.385/2021 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. për përfundimin e marrëdhënies së punës me rasatin e pensionimit, duke



pretenduar që sipas kontratës kolektive ti njohët e drejta e tri pagave mujore me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.06.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Më datë 10.06.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 2765/2021 të datë 01.06.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 28.04.2021 me nr.385/2021 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Vendimi i datës 28.04.2021 me nr.386/2021 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. Autorizimin e datës 21.05.2021; Kopja e ID identifikuese; Akt Emërimit të datës 04.01.2012 të ankueses; Kopja e konkursit për avancim; Vërtetim i datës 26.05.2021; Zarin e postes i datës 29.05.2021; Kërkesë për pagesë retroaktive/ Kërkesë për pagesë retroaktive; lista e pagave dhe Përgjigjen në ankesë e datës 10.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 04.01.2012 ka qenë e punësuar në pozitën "Zyrtare për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta " në Zyrën e Sekretarit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës dhe Sportit, më datë 28.04.2021 ka nxjerr Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës me arritjen e moshës së pensionimit e cila i përfundon me datë 14.05.2021, duke i njohur të drejtën e një page përcjellëse me rastin e pensionimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që nuk i është njohur e drejta e kompensimit prej tri pagave mujore me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas kontratës kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, ka konstatuar se Marrëveshja Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, ndërsa sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, është përcaktuar që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mbi bazë të kësaj mund të konstatojmë që Marrëveshja Kolektive e Kosovës ka qenë në fuqi deri më datë 01.01.2018, si rrjedhojë pas kësaj date nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit sipas Vendimit të datës 28.04.2021



të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit përfundon më datë 14.05.2021, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, meqenëse konstaton që Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, atëherë kompensimin me rastin e pensionimit të nëpunësve civil bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, kështu që Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 28.04.2021 me nr.385/2021 me të cilin ankueses i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara. Sa i përket pagës jubilarë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, me datën 05.05.2021 ankueses i është realizuar pagesa prej nëntëdhjetë e shtatë (97) euro sipas Vendimit të datës 28.04.2021 me nr.386/2021 të nxjerrë nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Poashtu pretendim tjetër i ankueses është ngritja e koeficientit prej 7 në koeficientin 8, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse ankuesja Akt emërimin për pozitën "Zyrtare për Barazi Gjinore dhe Mundësi të Barabarta e ka nënshkruar me datën 20.01.2012, kërkesën për ngritje të koeficientit e ka parashtruar me datën 06.05.2014 dhe me datën 17.12.2020 e cila në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me legjislacionit e shërbimit civil në fuqi, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020 si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vlerëson se çdo nëpunës civil ka të drejtën të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 ka përcaktuar se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.474/2021, datë 21/06/2021

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësueses së ankueses Avokates
- Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

